



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr/036 Date 19.12.2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
" UJESJELLES - KANALIZIME" KURBIN SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise " Ujesjelles - Kanalizime " Kurbin, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 46.3 % nga Bashkia Laç, 33.9 % nga Bashkia Mamurras dhe 19.8 % nga Komuna Milot, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore".

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



APLIKANTI
KASTRIOT MARKU

Laç, më 12.05.2016.

VENDIM

NR.2, DATË 12.05.2016

I ASAMBLESE SË PËRGJITHSËME TË AKSIONARËVE

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit Nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë", të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve në mbledhjen e datës 12.05.2016 vendosi:

1. Të miratojë Statutin e Shoqërisë Aksionare "Ujësijellësi i Bashkisë Kurbin", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të depozitohet pranë QKB.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARI I VETËM

BASHKIA KURBIN

ARTUR BARDHI

